



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KABINETI

NJOFTIM PËR SHTYP

Rasti: Përftimi i kontrollit të shoqërisë H-TEC Systems GmbH nga shoqëria MAN Energy Solutions SE.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar shkresa nr. 453 Prot., protokoll i AK-së, datë 18.12.2020, “Përqendrimi ndërmjet MAN Energy Solutions SE dhe H-TEC Systems GmbH”, me të cilën jemi njoftuar mbi transaksionin e përfimit të kontrollit të shoqërisë H-TEC Systems GmbH nga shoqëria MAN Energy Solutions SE.

Sipas Marrëveshjes së Shit-Blerjes së Aksioneve, të nënshkruar më datë 20 nëntor 2020, palët janë:

Pala blerëse: MAN Energy Solutions SE është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit Gjerman, me objekt aktiviteti prodhimin, shpërndarjen dhe mirëmbajtjen e makinerive dhe aparateve të të gjitha llojeve, veçanërisht të motorëve me naftë, duke përfshirë edhe motorët e anijeve dhe motorët për impiante stacionare dhe të makinerive turbo.

MAN Energy Solutions SE është një filial i zotëruar indirekt nga grupi Volkswagen Aktiengesellschaft. Grupit Volkswagen operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij: Porsche Albania SHPK, Porsche Leasing SHPK dhe Porsche Mobility SHPK.

Pala shitëse: GP JOULE IPP Assets GmbH është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit Gjerman, me objekt aktiviteti mbajtjen e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të pjesëmarrjes në shoqëri të tjera.

Shoqëri Target: H-TEC Systems GmbH është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit Gjerman, me objekt aktiviteti projektimin, prodhimin dhe shitjen e pajisjeve dhe impianteve, duke përfshirë hardware dhe software, si dhe konsulencë dhe shërbime në fushën e teknologjisë së hidrogjenit dhe teknologjive të lidhura me të.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.